

VENDIM
Nr. 116, datë 13.2.2013

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE,
MAGAZINË, GARAZH DHE LAVANTERI E INFEKTIVIT, NË SPITALIN RAJONAL
ELBASAN, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Spitalit Rajonal Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për t’u përdorur nga universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|---|
| - Magazinë (ish-zdrukthtaria) | sip. 132.7 m ² , zona kadastrale 7/27; |
| - Garazhi i autoambulancave | sip. 75.2 m ² , zona kadastrale 7/21; |
| - Lavanteri e infektivit
(e papërdorshme) | sip. 120.0 m ² , zona kadastrale 7/21. |

2. Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha